

PARANDALIMI I TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Material informues për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore për nxënësit e shkollës fillore nga klasa e VI deri në klasën e IX

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës




COUNCIL OF EUROPE



Zbatohet nga Këshilli i Evropës





Zyra e Programit të Këshillit të Evropës në Shkup,
Qendra e Biznesit Soravia
Filip Vtori Makedonski 3,
1000 Shkup
Tel. +38923100 333

Website: <http://horizontal-facility-eu.coe.int>
E-mail: horizontal.facility@coe.int
Facebook@[jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)
Twitter@[CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “©Këshilli i Evropës, viti i botimit”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

@ Këshilli i Evropës, nëntor 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.


Ky produkt është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

A keni dëgjuar ndonjëherë për **trafikimin e fëmijëve** ?
Ndoshta disa nga ju keni dëgjuar, por nuk e dini se çfarë është, ndërsa të tjerët nuk e kenë dëgjuar.

Trafikimi i fëmijëve është një krim.

Duhet ta kuptoni domethënien e këtyre fjalëve, në mënyrë që të mund të mbroni veten,
mos të bëheni viktimë dhe të përjetoni **keqtrajtime dhe abuzime serioze.**

HISTORIA E ANËS DO T'JU NDIHMOJË TË KUPTONI SE ÇFARË ËSHTË TRAFIKIMI I FËMIJËVE:



Jetoj në një qytet të madh; jam nxënëse e klasës së gjashtë. Jam nxënëse e shkëlqyer dhe shumë e dua leximin.

Një ditë, para se të shkoja në shkollë, vendosa të shkoj në bibliotekë për ta kthyer librin që kisha marrë hua dhe për të marrë një tjetër. Kur dola nga shtëpia ime, pashë një taksi të parkuar sikur po priste dikë. Kur po kaloja përkras makinës, shoferi i taksisë hapi dritaren dhe më pyeti ku po shkoja. U përgjigja që së pari do shkoja në bibliotekë dhe më pas në shkollë.

Shoferi i taksisë tha se personi që e priste nuk kishte ardhur dhe se do të më çonte deri në bibliotekë falas, kështu që nuk do të vonoja për në shkollë.



U futa në taksi dhe shpejt pas kësaj vura re që ai nuk po shkon drejt bibliotekës, i kërkova që të ndalet por ai tha që kishte një gjë të vogël për të bërë dhe se do të më kthente pas kësaj.



Kur u larguam nga qyteti, u ndal pranë një makine në një rrugë të ngushtë. Një njeri po dilte nga makina. Shoferi i taksisë mbylli derën e taksisë me çelës dhe filloi të flasë me të.



Më pas erdhi dhe më mori me forcë dhe më futi në makinën e tij, ku ishin dy fëmijë të tjerë, një djalë dhe një vajzë, më në moshë se unë.

Qaja dhe e lusja që të më lëshonte ndërsa të tjerët nuk po thoshin asgjë.






Nuk na lejohej t'i flisnim njëri-tjetrit. Pas një udhëtimi të gjatë, arritëm në një vend të fëlliqur. Na nxorën nga makina dhe na dorëzuan te dy burra me të cilët vazhduam të ecnim nëpër një shteg të ngushtë pyjor. Ishte errët dhe duhej të heshtim. Nuk e dija ku ishim ose ku po shkonim, nuk më lejuan të pyes, ishte shumë ftohtë. Kaluam nëpër një kalim të ngushtë.



Nga ana tjetër kishte njerëz që na prisnin me dy makina. Dolën dy burra, njëri prej tyre më mori mua dhe tjetri mori dy fëmijët e tjerë. Burri në makinë më tha, në një gjuhë që nuk mund ta kuptoja plotësisht, se do më çonte në shtëpinë e tij, ku do të jetoja me të, gruan dhe fëmijën e tij. I thashë që nuk doja të shkoja, se doja të shkoja në shtëpi, por nuk më dëgjoi fare.



Mbërritëm në banesë. Gruaja më dha bukë me çaj dhe më tregoi vendin se ku do të flija. Ishte një dhomë shumë e vogël ku ata ruanin gjëra. Nuk kishte ngrohje dhe ishte shumë errët. Isha shumë e lodhur dhe vështirë më zuri gjumi, kur gruaja erdhi dhe më zgjoi. Fliste shpejt, dhe nuk mund ta kuptoja shumë mirë. Mi tha të gjitha që duhej t'i të bëja në shtëpi dhe të kujdesem për fëmijën. I thashë: "Unë nuk di si t'i bëj gjithë këto dhe nuk di si të kujdesem për një fëmijë". Ajo tha: "Do ta mësosh". Ajo dhe burri i saj shkuan në punë, unë i lapa enët, pastrova, e vasha dhe e ushqeva fëmijën. Dera ishte e mbyllur me çelës, dhe nuk më lejohej të dilja.



Ata ktheheshin vonë në shtëpi dhe linin ushqim vetëm për fëmijën, unë ushqehesha me mbetjet nga një ditë më parë. Kështu ishte çdo ditë. Kisha frikë, por nuk e dija se sa do të zgjaste kjo, sepse ata më thanë që do të më çonin përsëri në shtëpi një ditë. Nuk e di sa kohë kishte kaluar, një muaj apo dy dhe sa herë që pyesja kur do të më kthenin, ata më ofendonin dhe nëse fëmija qante, më rrihnin.



Një ditë, fëmija kishte ethe dhe nuk dija çfarë të bëja. Nuk mund të telefonoja askënd, nuk kisha telefon dhe nuk kishte telefon as në apartament, por fëmija ishte shumë i sëmurë. Qëndrova pranë derës dhe fillova ta godas dhe të bërtas, duke shpresuar se dikush do të më dëgjojë. Fatmirësisht një grua më dëgjoji dhe pyeti se çfarë po ndodhte. I tregova se çfarë po ndodhte me fëmijën dhe ajo më pyeti se kush isha. Megjithëse nuk e dija kush ishte gruaja, i thashë që nuk isha e vendit dhe se njerëzit më mbanin të mbyllur. I tregova se nga isha dhe ia tregova numrin e telefonit të nënës. Gruaja më tha të vendosja një peshqir të lagur në kokën e fëmijës dhe u largua.



Ajo kishte telefonuar nënën time dhe i kishte treguar se ku gjendesha. Të nesërmen erdhën dy policë, hapën derën me forcë, më gjetën dhe më çuan në stacionin e policisë, ku po më priste babai. Unë qaja, kam qarë shumë, babai im qante gjithashtu, nuk mund të flisja. Të shoqëruar nga policia, shkuam në shtëpi.

M'u desh pak kohë për të kuptuar që kisha shpëtuar. Ende kam frikë; Nuk u besoj njerëzve, madje as atyre që i njoh.

PSE U BË ANA VIKTIMË E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE?

- Nuk dinte asgjë për trafikimin e fëmijëve,
- Nuk dinte për rreziqet e trafikimit të fëmijëve,
- I besoi dhe pranoi një favor nga një i panjohur,
- Pranoi një favor që nuk e kishte kërkuar,
- Nuk e mendoi arsyen se pse shoferi i taksisë do ta voziste falas.

KI KUJDES

Një trafikant mund të kërkojë ndihmë si një mënyrë për të joshur një viktimë potenciale. Mund të kërkojë që t'i tregosh rrugën, ose për t'i ndihmuar me diçka. Njerëzit e rritur nuk duhet të kërkojnë ndihmë nga fëmijët, ata duhet të pyesin një tjetër të rritur! Trafikantët përpiqen të fitojnë besimin e fëmijës. Ata mund të mashtrojnë, detyrojnë ose bindin fëmijët të lënë shtëpitë e tyre dhe t'i ndjekin ata. Trafikimi i fëmijëve mund të përfshijë disa persona që rekrutojnë, transportojnë dhe shfrytëzojnë fëmijët brenda ose përtej kufijve.

ÇFARË ËSHTË TRAFIKIMI I FILMIJËVE?

Trafikimi i fëmijëve është kur fëmijët rekrutohen, zhvendosen nga një vend në një tjetër ose nga një shtet në tjetër, merren dhe strehohen me qëllim **të shfrytëzimit ose keqtrajtimit** në mënyra të ndryshme

SI MUND TË BËHEN FËMIJËT VIKTIMA TË TRAFIKIMIT?

- Të mashtrohen përmes rrjeteve sociale, duke takuar njerëz në internet (miqësi, shkëmbim të fotografive private që mund të përdoren për zhatje),
- Të mashtrohen përmes shpalljeve tërheqëse në media,
- Të rrëmbehen / të vidhen nga familjet e tyre.

MËNYRAT E SHFRYTËZIMIT DHE KEQTRAJTIMIT TË FËMIJËVE:

- Pornografia
- Servituti në shtëpi
- Lypje
- Puna në rrugë (larja e xhamave, shitja e gjërave),
- Puna në fermat bujqësore, fabrikat,
- Krimi në rrugë,

- Martesë e detyruar,
- Birësim i paligjshëm,
- Heqja e organeve.

KUSH MUND TË JETË VIKTIMË E TRAFIKIMIT?

Fëmijët mund të mashtrohen dhe trafikohen nga të rritur të njohur dhe të panjohur nga komuniteti, të huaj, por edhe miq, anëtarë të afërt të familjes dhe ndonjëherë edhe nga familjarët më të afërt.

SI NDJEHEN FËMIJËT VIKTIMA:

- Vuajnë nga mungesa e kujdesit ose keqtrajtimit fizik dhe psikologjik,
- Trajtohen si skllëvër për të përfituar nga ta,
- Ndjehen të izoluar dhe të vetmuar,
- Ju shkelen të drejtat,
- Janë me shëndet të ligë ose janë të sëmurë,
- E kanë jetën në rrezik.

SI MUND TË MBROHESH?

- Trego kujdes kur flet me njerëz që kanë një sjellje ose kërkesë të pazakontë - ata mund të jenë të panjohur, por edhe dikush që ti e njeh;
- Ki kujdes kur dikush të ofron një favor që nuk e ke kërkuar dhe veçanërisht nëse ai favor ose dhuratë duket tepër mirë për të qenë e vërtetë;
- Ki kujdes kur një i rritur kërkon ndihmë nga një fëmijë - të rriturit duhet të kërkojnë ndihmë nga të rriturit e tjerë!

- Interneti është një vend i mahnitshëm, por edhe një vend ku njerëzit lehtë mund të shtiren se janë dikush tjetër. Gjithmonë ki kujdes kur pranon ftesa për miqësi me një person që nuk e ke takuar. Gjithmonë bisedo me personin që i beson rreth dyshimeve ose ftesave ose ofertave tepër të mira për të qenë të vërteta, në internet.
- Bisedo me prindërit, gjyshërit, motrat dhe vëllezërit, kujdestarët, mësuesit dhe miqtë e tu - ndaji me ta mendimet, frikën dhe shpresat e tua.
- Kujdesu për shokët dhe shoqet, në të njëjtën mënyrë si ata që kujdesen për ty - kushtoi vëmendje asaj që ndodh me ta dhe ofroi ndihmë kur vëren se diçka nuk është në rregull.
- Besoju ndjenjave dhe emocioneve tua - nëse ndjen se diçka nuk është në rregull edhe se nuk e din se çfarë është saktësisht - me siguri ke të drejtë. (ndjenja "Oh-oh").

RREGULLAT E NJEJTA VLEJNË PËR BOTËN NË INTERNET !

Rrjetet sociale, platformat dhe kanalet ofrojnë shumë përmbajtje interesante. Sidoqoftë, ato gjithashtu mund të shërbejnë si një mjet për rekrutimin e viktimave.

- Ki kujdes se çfarë poston për veten - çfarë lloj fotografish, përmbajtjesh...
- Edhe sikur të pranosh komunikimin në Internet me një person që nuk e ke takuar kurrë, gjithmonë duhet ta kujtosh se pas profilit mund të qëndrojë çfarëdo personi.
- Nëse miku yt i ri në internet të kërkon t'i dërgosh fotografitë e tua ose hollësi rreth asaj se ku jeton, në cilën shkollë shkon ose ku e kalon kohën - menjëherë njofto prindin tënd, gjyshërit, kujdestarin, mësuesen ose mësuesin ose të paktën shokun/shoqen tënde të ngushtë.
- NJOFTO prindin, gjyshin/en, kujdestarin/en, mësuesin/en ose të paktën shokun ose shoqen e ngushtë nëse një person që e ke takuar në internet po përpiqet të të takojë personalisht.
- KURRË mos prano ftesë për të takuar VETËM një person që nuk e njeh mirë ose nuk e njeh fare. Kjo mund të jetë e rrezikshme për një të rritur, e lëre më për një fëmijë.

TANI DIN MË SHUMË RRETH TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE:

- Nuk do mund të mashtrohesh aq lehtë.
- E din që ekzistojnë ligje në vendin tënd që ndalojnë rreptësishtë trafikimin e qenieve njerëzore.
- E din që policia, shërbimet sociale, gjyqësori dhe institucione dhe organizata të tjera në vendin tonë po bëjnë përpjekje për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore.
- Sikur edhe të futesh në zinxhirin e trafikimit do ta dish se NUK është faji yt.
- Mos harro - çdo person nën 18 vjeç trajtohet gjithmonë si viktimë, edhe nëse e kanë detyruar ose e kanë mashtruar që të japë "pëlqim" për çdo lloj shfrytëzimi.

Zyra e Programit të Këshillit të Evropës në Shkup,
Qendra e Biznesit Soravia
Filip Vtori Makedonski 3,
1000 Shkup
Tel. +38923100 333

Website: <http://horizontal-facility-eu.coe.int>
E-mail: horizontal.facility@coe.int
[Facebook@jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)
[Twitter@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës




Këshilli i Evropës është organizata kryesore për të drejtat e njeriut në kontinent. Ai përfshin 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës janë palë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një marrëveshje e krijuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në vendet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar të shkëmbejë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu



Ky produkt është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.